

## KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Sot më datë 11/11/2022, bazuar në nenin 73 pika 1/b të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe nenin 705 e vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", nënshkruhet kjo kontratë për shitjen e kuotave të Shoqërisë "\_DO UT DES\_" Sh.p.k, si më poshtë vijon:

### Neni 1 Palët Kontraktuese

Z. Saimir Dudija, i datelindjes 10/07/1982, lindur ne Elbasan, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Leternjoftimin me nr. personal I20710036M , ne cilesine e ortakut te Shoqërisë "DO UT DES" Sh.p.k, me NIPT L51720008T .

*Nga këtu e më poshtë referuar si "SHITËSI"*

dhe

Znj. Dorian Mamillo ,e datelindjes 30/01/1984, lindur ne Polican, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Leternjoftimin me nr. Personal I45130031U.

*Nga këtu e më poshtë referuar si "BLERËSI"*

### Neni 2 Objekti i Kontratës

2.1 Objekti i kontratës është shitja nga Shitësi tek Blerësi, i 1 (nje) kuote ne vleren nomonale 100 000 (Njeqind mije ) leke te kapitalit themeltar te Shoqërinë "\_DO UT DES\_" Sh.p.k, ose 100 % te kapitalit qe zotrohet nga ortaku i vetem i shoqërisë Z. Saimir Dudija.

### Neni 3 Çmimi i Shitjes.

3.1 Çmimi total i shitjes së kuotes ne vlere nominale që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi është 100 000 Leke Njeqinde mije lek( Leke).

### Neni 4 Mënyra e Pagesës

4.1 Çmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, është likuiduar prej Blerësit perpara nenshkrimit te kesaj kontrate .



## Neni 5

### Detyrimet e Shitësit

- 5.1 Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së 100 % të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar ose të 1 (një) kuote që ai zoteron në shoqërinë "DO UT DES" Sh.p.k, kuote e cila tashmë i kalojnë Blerësit.
- 5.2 Shitësi garanton se kuota, e cila shitet me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i saj e gëzon të drejta të plota mbi të.
- 5.3 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë të zotëruara prej tij objekt i kësaj kontrate.

## Neni 6

### Detyrimet e Blerësit

- 6.1 Blerësi ka paguar çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.
- 6.2 Blerësi do të marrë të gjitha masat për të regjistruar transferimin e kuotave që Shitësi i kalon atij, në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 6.3 Blerësi fiton të drejta dhe detyrime mbi kuotën objekt i kontrates menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe detyrimet dhe të drejtat që kanë lindur përpara nënshkrimit të kësaj kontrate janë në ngarkim dhe përfitim të Shitësit.

## Neni 7

### Konfigurimi pas Shitjes së Kuotave

- 7.1 Pas shitjes së kuotave konfigurimi i kuotave Shoqërisë "DO UT DES" Sh.p.k, do të jetë:
  - Znj. Doriana Mamillo zoteron 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë e përbere nga 1 (një) kuote në vlerën 100 000 (Njëqinde mijë) leke;

## Neni 8

### Mosmarreveshjet

- 8.1 Mosmarreveshjet që lindin nga kjo kontratë do të zgjidhen me mirekuptim nga të dy palët, në rast të kundërt do të drejtohen Gjykatës Kompetente Shqiptare.

## Neni 9

### Gjuha e Kontrates dhe Hyrja në Fuqi

- 9.1 Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) ekzemplarë, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale, dhe pasi i'u lexua palëve, u nënshkrua rregullisht prej tyre.
- 9.2 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

**SHITËSI**

Saimir Dudija



**BLERËSI**

Doriana Mamillo

**VENDIM**  
**I ASAMBLESE SE ORTAKEVE**  
**Nr. 1 Date 11 / 11 / 2022**

Sot me date 11/ 11 /2022, Une Saimir Dudija , ortak i vetem i shoqerise “DO UT DES” Shpk me 100% te kuotave te kapitalit.

**VENDOSA:**

1. Ortaku i vetem i shoqerise Z . Saimir Dudija te shesi 100 % te kuotave , te cilat perbejne 100 pjese , me vlere 100 000 leke (njqind mije leke ) te zoteruara prej saj , Znj. Doriana Mamillo.
2. Blersi i ketyre kuotave eshte Znj. Doriana Mamillo e cila behet zoteruese e 100 % te kuotave , te cilat perbejn 100 pjese me vlere 100 000 leke (njqind mije leke ).
3. Te behet dhe ndryshimi i aktivitetit te shoqerise :

**Ishte:** Aktivitet marketingu, analize tregu dhe sherbime te tjera marketing te lidhura me shoqerite. Import-Eksport dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me objektin e mesiperm, kryerjen e sherbimeve perkatese ne lidhje me to

**Te behet:** Sherbime Financiare

4. Te kryej rregjistrimin e ketij vendimi ne Qendren Kombetare te Biznesit QKB brenda afateve ligjore .

**Ortaku i vetem i**  
**Shoqerise “ DO UT DES ” Sh.p.k**



**Saimir Dudija**

*SAYMIR DUDIJA*